



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 1663 prot

Vlorë më 23/10/2024

VENDIM

Nr. 19 datë 22/10/2024

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 PËR QËNDRËN PSIKO-SOCIALE
"VATRA"

Këshilli i Qarkut Vlorë, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës së Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Qendrës Psiko-Sociale "Vatra", mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore". i ndryshuar, neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41, neni 72 pika 5, neni 77 pika dhe, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40.
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 97/2023 datë 7.12.2023 "Për Buxhetin e vitit 2024".
- V.K.M. nr. 503 dt. 01.08.2024 "Për disa ndryshime nr Vendimin nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufinjve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore."
- V.K.M. nr. 421 dt. 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar."
- V.K.M. nr. 224/2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror".
- Shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me lëndë:"Njoftim" me Nr.3941 Prot datë 20.09.2024, protokolluar me tonën me Nr.1445 Prot datë 24.09.2024.

VENDOSI:

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës Labëria, kat i Tretë
Rruga "Fejzo Gjomema" Shtëpi
Vlorë

E-mail: info@qarkuvlore.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

1. Të miratojë buxhetin për Qendrën Psiko-Sociale "Vatra" në vlerën 20,143,418 lekë, të detajuar si më poshtë:

a- Ky fond do të shpërndahet në buxhetin e vitit 2025 për Qendrën Psiko-Sociale "Vatra" sipas strukturave buxhetore të mëposhtme:

-llogaria 600	14,350,418 lekë
-llogaria 601	2,396,520 lekë
-llogaria 602	3,396,480 lekë

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2024

Adresa: Keshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës Labëria, kati i Trehtë
Rruga "Fejzo Gjomema" Skelë
Vlorë

E-mail: info@garkuvlore.gov.al



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

RELACION

Në kuadër të vazhdimësisë të projektit të Qendrës Psiko-sociale "Vatra" me fokus të vecantë në mbrojtje të grave të dhunuara dhe të trafikuar e miratuar me Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë Nr.9, datë 11.03.2015 për projektin "Ofrimi i asistencës direkte për fuqizimin social dhe ekonomik të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në qarkun e Vlorës", implementuar nga Qendra Psiko - Sociale "Vatra", mbështetur në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.3941 Prot, datë 20.09.2024, protokolluar me tonën me Nr.1445 Prot, datë 24.09.2024 me qëllim përfitim nga mekanizmit i Fondit Social për financimin e shërbimeve komunitare të kujdesit shoqëror, projekti për vitin 2025 duhet të jetë i buxhetuar dhe i miratuar me Vendim të Këshillit të Qarkut.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data e përcaktuar 25.10.2024 pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Për këtë arsye nisur afatet e limituara kohore për dorëzimin e Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë në Ministrinë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kërkohet zhvillimi i një mbledhje këshilli jashtë radhe.

Punoi

Specialiste Arsimit/Kulturës/Turizmit/Çështjeve Sociale dhe Zhvillimit të Projekteve

Ilda Lamaj